



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Instituti për Mjekësinë Ligjore
Institut za Sudsku Medicinu / Institute for Forensic Medicine
Divizioni për Burime Njerëzore - Odsek za Ljudske Resurse - Division of Human Resources

DBNJ- Nr. 04/2022
Datë: 27.04.2022

Duke u bazuar në nënparagrafin 3.1 të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 68 të Ligjin Nr.06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare Nr. 8 / 11 mars 2019), Ligjin Nr.03/L-212 i Punës dhe nënparagrafin 5.1 të paragrafit 5 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, nxjerr:

VENDIM

Mbi anulimin e Konkursit të brendshëm në IML

1. Anulohet procedura e rekrutimit të konkurseve të brendshme në Institutin e Mjekësisë Ligjore të publikuara me datën e njoftimit 03.03.2022, në afatin për aplikim nga 02.04.2022 deri më 16.04.2022 për pozitat:
 - 1.1 Drejtor i Përgjithshëm- 1 (një) vend pune;
Drejtor i Departamentit për Mbështetje Mjeko Ligjore - 1 (një) vend pune;
Drejtor i Departamentit për Mjekësi Ligjore- 1 (një) vend pune;
Drejtor i Departamentit për Laboratore Mjeko Ligjore- 1 (një) vend pune dhe Udhëheqësi i Divizionit për Cilësi - 1 (një) vend pune.
2. Vendimi hyn në fuqi me datë 27.04.2022

ARSYETIM

Divizioni për Burime Njerëzore gjatë fazës së verifikimit paraprak ka konstatuar se në konkursin e publikuar për aplikim me datën 02.04.2022 për konkursin e brendshëm për pozitat: Drejtor i Përgjithshëm- 1 (një) vend pune, Drejtor i Departamentit për Mbështetje

Mjeko Ligjore - 1 (një) vend pune, Drejtor i Departamentit për Mjekësi Ligjore- 1 (një) vend pune, Drejtor i Departamentit për Laboratore Mjeko Ligjore- 1 (një) vend pune dhe Udhëheqësi i Divizionit për Cilësi - 1 (një) vend pune, duhet të përsëritet sepse së paku tre kandidatë nuk i plotësojnë kushtet e parapara për këto pozita të shpallura me konkurs, e i cili do të përsëritet brenda afatit ligjor të parapare me ligj.

Andaj, bazuar në nënparagrafin 3.1 të paragrafit 3 dhe 4 të nenit 68 të Ligjin Nr.06/L - 114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare Nr. 8 / 11 mars 2019), Ligjin Nr.03/L-212 i Punës dhe nënparagrafin 5.1 të paragrafit 5 të nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Arta Nuredini Durmishi
Udhëheqëse e Divizionit për Burime Njerëzore